



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren- Prizren Belediyesi

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Mytaher Haskuka- Kryetar i Komunës së Prizrenit

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR
RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS PROJEKTET E FINANCUARA NGA GRANTI I PERFORMANCËS KOMUNALE
PËR VITIN FISKAL 2019

Prizren, qershor 2021

Nr	Komponenta e auditimit(kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	3.1 Procesi i priorittizimit të projekteve në të cilat është investuar	Komuna e Prizrenit – vendosë për projektet në të cilat do të investohet bazuar në planifikimet buxhetore dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale.	<p>1. Të vendosin proces të dokumentuar të priorittizimit të projekteve në të cilat do të investohet. Komunitat duhet që të përcaktojnë kriteret për priorittizimin e projekteve duke u bazuar në rëndësinë strategjike, vlerësimin ekonomik dhe financiar dhe të bëjnë vlerësimin e gatishmërisë së zbatimit të projektit;</p> <p>2. Palët relevante të menaxhimit të Grantit të Performancës Komunale të rishikojnë mundësinë e vlerësimit/definimit më të hershëm të projekteve për financim, me qëllim të analizimit dhe vendosjes së projekteve me kohë krahas planifikimeve buxhetore dhe rrjedhimisht përfundimin e tyre sipas kërkesave të marrëveshjes;</p>	Do të synohet që në aplikimet e ardhëshme në projektet e tilla, për projektet të cilat do të jenë të planifikuara në buxhet	Zyrtari përgjegjës i projekteve brenda drejtorive	Viti 2022
2	3.2 Menaxhimi i projekteve në raport me kërkesat e marrëveshjes-	Mangësi në procesin e realizimit të projekteve kapitale- Në komunën e Prizrenit shkaktarë i vonësive në liferim të mallit ishte OE-ja, i cili ka dërguar mallin me vonë në komunë dhe kjo e fundit nuk ka	3. Komunitat të fillojnë me inicimin e realizimit të projekteve dhe procedurave të prokurimit në momentin e aprovimit të kërkesës nga njësi kërkuese dhe të evitohen pengesat e padobishme në procesin e prokurimit deri te nënshkrimi i kontratës, në mënyrë	-Do të ndërmerren të gjitha veprimet sipas dinamikës së paraparë në kontrata	Menaxheri i kontratës dhe Organi mbikqyrës	Gjatë vitit 2022

		marrë ndonjë veprim në këtë drejtim	që të evitohet nënshkrimi i kontratave në pjesën e fundit të vitit;			
3	3.3 Granti i Performancës Komunale dhe rezultatet e synuara	Komuna e Prizrenit ka realizuar projektin për blerjen e pajisjeve medicinale për nevojat e Qendrës Emergjente të Mjekësisë Familjare në Prizren me qëllim trajnimin e stafit. Sipas zyrtarëve përgjegjës, një pjesë e trajnimeve janë mbajtur fillimisht, mirëpo pjesa e dytë e trajnimeve të parapara të mbahen për ekipet e emergjencës nuk janë mbajtur për shkak të pandemisë COVID-19 dhe si pasojë projekti nuk është plotësisht në shfrytëzim.	4. Komunat të sigurojnë kushte të përshtatshme për Operatorët Ekonomik që me rastin e nënshkrimit të kontratave të punës projektet të fillojnë dhe të realizohen pa pengesa; dhe 4.1 Menaxherët e projekteve të sigurohen që OE-të përmbushin të gjitha detyrimet kontraktuale dhe në rastet kur të njëjtit nuk i përgjigjen obligimeve të rekomandohen masat juridike të parapara në kontratë.	Planifikimi i tyre sipas dinamikës do të duhej të realizohet me se shumti nga muaji Dhjetor 2021-Janar 2022 por, egziston mundësia nese na paraqitet nje “zbrazeti” qe kjo te realizohet edhe me heret.	Menaxheri i Kontratës dhe Organi Mbikqyrës	Dhjetor 2021-janar 2022

Qershor, 2021
Prizren

Kryetari i Komunës së Prizrenit:

/ z / Mytaher Haskuka

